



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2175/2 prot

Tepelenë, më 02.11. 2023

V E N D I M

Nr.81. datë. 31.10.2023

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN SHTATOR 2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 21 të ligjit nr 57/2019 " Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 597 datë 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike " nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2023". Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave . "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021;

Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr 4 datë 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve , procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës 31.10.2023

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% per muajin **Shtator 2023**, **17** familje me fond **83775 lekë** , bashkëlidhur sipas tabelës .

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NR.ANTAREVE NE FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	BARJAM ILJAZ KOKOTI	2	5346
2	BUJAR VESEL METO	1	2178

3	ANULA KANAN MAMA	2	3703
4	JETNOR ZYBER CUNAJ	1	2178
5	ELTON BARJAM CELA	2	3267
6	MONIKA SAFET BETA	3	7920
7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
8	BRUNILDA MYZAFER KERI	4	10692
9	ALMIRA CETI HAZBIA	1	2178
10	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
11	MELISA DULAJ	2	5940
12	BRUNILDA RIZA MAMAJ	2	3703
13	MAJLINDA EQEREM BAKO	2	3703
	SHUMA		65203
	NJESIA ADM. QENDER		
1	HEDO GOXHA	3	5227
2	ANDON SHUMELI	3	5227
	SHUMA		10454
	NJESIA ADM. KURVELESH		
1	MARJETA VESHI	1	2178
	NJESIA ADM LOPES		
1	KLODJANA ZENEL SULAJ	2	5940
	SHUMA		5940
		SHUMA TOTALE	83775

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar , Drejtoria Ligjore (sektori I ndihmës ekonomike), Njësiti Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratur me 12(dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12(dymbëdhjetë)

Vota Kundër 1(një)

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.11.2023.

KRYETAR KËSHILLI

ARBEN GUMENI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2175/3 Prot

Tepelenë, më 02.11.2023

**V E N D I M
Nr.82.Datë 31.10.2023**

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE BUXHETIT TË KËSHILLIT
BASHKIAK TEPELENË PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, në zbatim të planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2024, të Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë, Kreu VIII, Financimi i Aktiviteteve të Këshillit neni 114, Buxhetimi vjetor i shpenzimeve të Këshillit pika 1, neni 115 Miratimi i projektbuxhetit vjetor të Këshillit pika 1,2 Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 31/10/2023 pas diskutimeve

V E N D O S I:

1. Të miratohet plani i aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2024, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të përcillet në Bashki për t’u përfshirë në projekt dokumentin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetar I Këshillit Sekretari Këshillit dhe administrata e Bashkisë.
4. Ky vendim hyne në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETARI I KËSHILLIT
Arben GUMENI**



Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 02.11.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.6. prot

Tepelenë, më 31.10.2023

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më datë 31.10.2023. ora 10.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Tepelenë thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar, me këtë rend dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 21.09.2023.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shtator 2023”.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2024”.
- Informacion mbi problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative Qëndër, Lopës, Kurvelesh, të Bashkisë Tepelenë.
- Çështje të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z, Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10.00

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Arben Gumeni
- Latif Kaçaj
- Dino Selimi
- Mirela Varfi
- Mjaftoni Zera
- Marsela Balili
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Marios Jorgo
- Vladimir Gjonca
- Ditar Hodaj

Marin pjesë nga Administrata e Bashkisë

- Shaban Loci
- Artur Ormeni

Kryetari i Këshillit Z.Arben Gumeni deklaron hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës ku drejton pyetje nëse jeni dakort me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësinë me rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota Pro 14: Arben Gumeni, Marjos Jorgo, Latif Kacaj, Dino Selimi, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Mece, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Pika e dytë e rendit të ditës: Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 21.09.2023.

Kryetari i Këshillit u drejton pyetje këshilltareve, në lidhje me procesverbaline mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakortësinë me përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
Votimi i hapur

Vota Pro 14: Arben Gumeni, Marjos, Jorgo, Latif Kacaj, Dino Selimi, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Besnik Mece, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda, Bishani, Ditar Hodaj.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Pika e tretë e rendit të ditës: Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shtator 2023

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Ky projektvendim nuk ka ndryshim nga muaji i kaluar.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: Cfarë kritere ka për të përfituar 6%, sa kohë mund të marrë një person këtë fond?

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumeni: Një person e mer këtë fond për aq kohë sa i takon, kriteret janë të përcaktuara.

Fjalën e mori Znj. Mjaftoni Zeraj: Për sa i përket ndihmës ekonomike ne mund të shprehim një mendim një sugjetim një iniciativ në lidhje për ndihmën ekonomike.

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumeni: Ne miratuam rendin e ditës dhe janë këto pika ju po keni gjithë tjetër ta mbajme shënim në proces verbal dhe ta diskutojmë me aparatën e Bashkisë çfarë mund të bëjmë për ndihmën ekonomike. Ne këtu jemi për të diskutuar këto projektvendime që na vijnë, ne para votimit të projektvendimit diskutojmë çfarë propozime keni ju për tja përcjell Administratës së Bashkisë.

Fjalën e mori Z. Larif Kacaj: Cfarë kritere kanë personat që përfitojnë 6%.

Fjalën e mori Administratorja e Njesisë Lopës Znj. Festime Elezi: Këta persona nuk i pranon sistemi kur bëjnë aplikimin sepse nuk marin pikët e mjaftueshme, janë familje në vështirësi ekonomike.

Fjalën e mori Z. Larif Kacaj: I keni verifikuar ju, një person nga Lopsi ku banon, pse është në vështirësi ekonomike?

Fjalën e mori Administratorja Njesisë Lopës Znj. Festime Elezi: Po i verifikojmë, banori banon në Tepelenë, është në vështirësi ekonomike, banon me prindërit është e divorcuar ka një fëmijë një prind të paralizuar, nuk ka asnjë të ardhur.

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumeni: Kjo ka të ardhura të vetat?

Fjalën e mori Administratorja e Njesisë Lopës Znj. Festime Elezi: Jo, sepse shoqëruese e nënës është i jati.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektaktit - votim i hapur.

Vota Pro 14: Arben Gumeni, Marjos Jorgo, Latif Kacaj, Dino Selimi, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Besnik Mece, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj.

Vota KUNDËR: 1. Latif Kacaj

Vota ABSTENIM: S'ka

- **Pika e katërt e rendit të ditës: Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2024**

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumeni: Plani i aktiviteteve në bazë të ligjit, u mblodh dhe kryesia e Këshillit diskutoi rreth këtij projektvendimi, kush ka ndonjë vërejtje sugjerim mund ta shtojmë, duke punuar me këtë plan nqs do na dalë ndonjë aktivitet ne mund ta shtojmë. Po keni propozim ose vërejtje mund ta thoni para se të kaloj për votim.

Kryetari i Këshillit drejton pyetjen, nëse ka pyetje dhe diskutime për këtë ceshtje.

Fjalën e mori Znj. Mjaftoni Zeraj: Pjesa më e madhe e këshilltarëve ishim në komision diskutuam dhe ram dakort për këtë projektvendim.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektaktit - votimi i hapur.

Vota Pro 14: Arben Gumeni, Marjos Jorgo, Latif Kacaj, Dino Selimi, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Besnik Mece, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- **Pika e pestë e rendit të ditës: Informacion mbi problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative Qëndër, Lopës, Kurvelesh të Bashkisë Tepelenë.**

Fjalën e mori Administratori i Njësisë Kurvelesh Z. Shaban Loci: Relaton materialin bashkëlidhur.

Kryetari i Këshillit drejton pyetjen, nëse ka pyetje dhe diskutime për këtë çështje.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: Fshati Nivicë i cili është tek 100 fshatrat, çfarë përfitimi keni si fshat? Në lidhje me sinjalistikën rrugore, duke filluar nga hyrja e qytetit Tepelenë, a ka sinjalistika treguese?

Fjalën e mori Z. Shaban Loci: Janë vendosur në brendësi të fshatrave, në fshatin Gusmar, në hyrje të vendosen në fshatin Bëncë, jemi në pritje, i kemi bërë kërkesë Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Në lidhje me përfitimin si 100 fshatrat, është rritur numri i turistëve, janë hapur disa bujtina.

Z. Vladimir Bakiaj: Çfarë ndihme keni konkretisht nga ana e Bashkisë?

Z. Arben Gumeni: Bashkia ka bërë investime të ndryshme, konkretisht sheshi qëndrës Nivicë, rruga etj. Kam një vërejtje që të mblidhen taksat - tatimet sipas ligjeve në fuqi, duhet të rritet përqindja e mbledhjes së taksave e tatimeve, pasi me të ardhurat rriten dhe më shumë investimet.

- Dhënia e tokave me qera nuk duhet të paraqitet në Këshill Bashkiak, pa u konfirmuar nga Kryeplaku i fshatit dhe Administratori Njësisë.

Fjalën e merr Z. Shaban Loci: Ne si administrator bëjmë afishimin publik të shoqëruar me relacion shpjegues, kurse për të gjitha procedurat merret Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Drejtoria Juridike pranë Bashkisë.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: Si po ecën procesi për zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave në Njesinë Adm. Kurvelesh?

Fjalën e merr Z. Shaban Loci: Ne kemi mbaruar procesin e zgjedhjes në 5 fshatrat, në zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave.

Përsa i përket vjeljes së taksave në vlerën prej 45 milion lekesh, nuk realizohet, pasi janë larguar familje, gjithsej janë 170 familje faktike në Kurvelesh.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: Cilat taksa nuk mbledh dot, ato të banesave, apo kullota etj?

Fjalën e mori Z. Shaban Loci: Asnjë lloj takse, as të druve, kullotave, banesa etj. pasi kullotat janë vlerësuar që në vitin 1981, dhe nuk janë lloj dhe sot në vitin 2023, unë kam kërkuar të bëhet vlerësim për kullotat.

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni: Këto shqetësime të shprehen në dëgjesën publike të buxhetit të vitit 2024, që do të zhvillohet në njësitet administrative.

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni, Administrator Njesisë Lopës: Referon materialin bashkalidhur.

Nga relatimi dolën disa problematika:

- 1.Ujësjiellësi Dhëmban - punimet janë shumë keq, nuk kanë ujë banorët
- 2.Rrugët e brendshme të fshatrave, rruga Sinanaj-Matohasanaj, fshati Dhëmban, Lagja Dashaj, fshati Dorez.
- 3.Shqetësimi me furnizimin me energji elektrike, pasi është bërë një riparim, por nuk mjafton.
- 4.Shqetësim për furnizimin me ujë në zonën Sinanaj.
- 5.Rikonstruksion i lera, janë 24 lera, të gjitha janë jashtë funksionit.
- 6.Riparimi i zyrave të Njesisë Administrative Lopës.

PYETJE:

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakaj: Për këto problematika të Njesisë tuaj është në dijeni Kryetari i Bashkisë? Në lidhje me ujësjiellësin është firmosur nga ana e juaj? Të njëjtën gjë po ju pyes edhe për rrugën.

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Bashkia nuk ka munguar asnjë herë ndihmë dhe mbështetja, por për disa problematika financiare. Ujësjiellësi fshatit Dhëmban nuk është marrë në dorëzim.

Fjalën e mori Zj. Mjaftoni Zeraj: Ujësjiellësi Dhëmban, ka punonjës, kush e paguan?

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Në ujësjiellësin e Dhëmbanit është i punësuar një punonjës, por është bërë një punë jo e mirë në ndërtimin e këtij ujësjiellësit.

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni: Mendoj se në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të thërrasim Drejtorin Rajonal Gjirokastër, në lidhje me Ujësjiellësin fshatit Dhëmban.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: Ke lidhur 18 kontrata për kullota, i ke shpallur në fshatra, a ka konflikte?

Fjalën e mori Z. Artrur Ormeni: Ne kemi bere njoftime, konsultime me pleqësine e fshatrave, ato janë në pronë publike dhe në bazë të kërkesave janë lidhur kontratat.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: Nga kush ka ardhur kërkesa dhe ka konflikte sot?

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Kërkesat kanë ardhur nga banorët, ka dhe konflikte, është lidhur një kontratë në fshatin Lab-Martalloz, duke marrë dhe mendimin e Drejtorit të Zhvillimit Rural, kjo kontratë është pengesë në komunitet dhe do të mundohemi ta zgjidhim.

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni: Për sa kohë është lidhur kontrata?

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Kontrata është 6 mujore dhe mbaron në Nëntor.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodo: Falenderoj administratorin e Njësise Lopës, për materialin e paraqitur në këtë mbledhje. Nga problematikat e ngritura do të vecoja:

1. Restaurimi i lervave, problematikë imediate

2. Rruget e brendshme në fshatin Matohasanaj, është fatkeqësi që janë në këtë gjendje, pasi është një fshat me Kala, ku mund të vizitohet nga turistë vendas dhe të huaj

3. Depozitimi i mbetjeve urbaneve, si hiqen?

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Kemi vendosur 6 kontenier funksional, por kemi i bërë kërkesë Bashkisë për të shtuar numrin e konteniereve.

Në rrugët e brendshme të këtyre fshatrave ka ndërhyre Bashkia, por këtu në këto rrugë duhet investim serioz, me kanalizime etj.

Fjalën e mori Zj. Matilda Cela: Meqënëse u diskutuan të gjitha problematikat, kërkojmë që në mbledhjen e radhes, Bashkia të na kthejë përgjigje për zgjidhjen e tyre.

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni: Kur kërkon investime, mbështetuni në të ardhurat që ju mblidhni. Si vazhdon ecuria e zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave?

Fjalën e mori Z. Artur Ormeni: Procesi i zgjedhjes së Kryetarëve të fshatrave ka përfunduar, dhe sot kemi sjell materialin konkrete. Në lidhje me vjeljen e taksave kombëtare, kemi probleme, pasi nga 450 familje që kanë qënë, sot faktik janë 190 familje.

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni : Njësitë Administrative duhet të nxirrni me shifra dhe t'ja paraqesni komisionit që hartojnë projekt-buxhetin për vjeljen e të ardhurave sipas gjëndjes tuaj faktike.

Në lidhje me relativimin e Njesisë Administrative Qëndër , për arsye të mungesës të Administratorit Z.Leonidha Shumeli, u përfaqësua nga Z. Myzafer Muci- Punonjës taksave.

Fjalën e mori Z. Myzafer Muci : Relatoj me shkrim (bashkalidhur)

Problematikat :

1.Rrugët në fshatin Dukaj

2.Lerat,

3.Ndricimi etj.

Në fshatin Dukaj , problematike rrugët e brendeshme.

Fjalën e mori Zj. Mirela Varfi : Është punuar në fshatin Dukaj , ndricimi nuk ka përfunduar, në lagjen Kordhaj rruga është problematike, të vendosen kontenier të tjerë,rruga për në varreza të rregullohet, nuk funksionojnë pompat e ujit,

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni : Ka pyetje të tjera ?

Nuk ka pyetje.

ÇËSHTJE TË TJERA :

Fjalën e mori Z. Arben Gumeni : Në Këshillin Bashkiak është paraqitur kërkesë nga Z.Pertef Kacorri, për dhënie titull “Qytetar nderi”(bashkalidhur materiali)

Duke u mbështetur në ligj, propozimet për titull nderi duhet të propozohen nga shoqata, organizata, për këtë arsye ti kthehet përgjigje me shkrim qytetarit.

-Kërkesë për ndihme financiare nga banori i Njesisë Administrative Qëndër , Z.Aristotel Meshini (bashkalidhur kërkesa). Me këtë kërkesë shprehën dakortësin të gjithë Këshilltarët, prandaj ti paraqitet aparatit të Bashkisë, zyrës përkatëse për tu trajtuar me ndihmë financiare sipas legjislacionit.

Kërkesë për tu riburësuar nxënësit e Njesisë Adm. Lopës për biletën e transportit
Mbyllet mbledhja e Këshillit.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI